



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Neni 4 par.3 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.02/2020 për procedurën e emërimit të Nënkyetarëve në Komuna, dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-1/298-10, dhe në bazë të shkresës së MAPL-Nr.02/129/2 dt.06.02.2020, duke përfshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisioni, të zgjedhur nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sport, përmes Thirrjes publike të dt. 21.09.2020, nxjerr:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR FINANCIM PUBLIK TË OJQ-ve NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve për financimin publik të OJQ-ve, për programet/projektet sipas Thirrjeve publike në fushën e aktiviteteve kulturore dhe rinore dhe të aktiviteteve sportive publikuar më 07.09.2020, themelohet komisioni në përbërje:

1. Jakup Gashi, kryesues, Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
2. Valon Shabani, anëtar, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave
3. Haxhere Ajvazi, anëtare, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave
4. Albina Imeri, anëtare, Shoqëria civile
5. Fitore Dibrani, anëtare, Shoqëria civile

z. Agim Idrizi, caktohet anëtar rezervë, i cili zëvendëson anëtarin e Komisionit në rast të paraqitjes së konflikti të interesit, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

Neni 2

Komisioni, detyra dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit
Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit
Arkivit

Nr. 02-020/04-0059386/20
Podujevë, 01 tetor 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Mbështetur në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, Rregulloren (QRK) nr.12/2020 për orarin e punës dhe pushimet e zyrtarëve publik, nenin 4 parag.3 të Udhëzimit Administrative (MPL) nr.02/2020 për procedurën e emërimit të nënkryetareve të komunave dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas Shkresës së MAPL-së 02-129/2 e dt. 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës së Podujevës, nxjerr,


URDHËRESË

- I. Urdhërohen të gjithë të punësuarit në Administratën e Komunës së Podujevës pa përjashtim, të respektojnë orarin e punës, përkatësisht **ardhjen në orën 8.00, vajtjen nga puna në orën 16.00, si dhe pauzën prej orës 12.00 – 13.00**, si dhe të evidentohen në sistemin elektronik në hyrje të objektit të Komunës.
- II. Të kthehen në orarin e rregullt të punës të gjithë zyrtarët publik të liruar nga puna për shkak të zbatimit të masave nga pandemia COVID-19, me përjashtim të atyre të cilët nuk mund të vijnë punën për shkak të gjendjes shëndetësore, të lejuar nga personeli mjekësorë.
- III. Gjate orarit të punës rreptësisht ndalohet dalja jashtë objektit të Komunës për kafe, ushqim ose gjera të ngjashme, për të gjithë të punësuarit sipas pikës I të kësaj Urdhërese, me përjashtim të rasteve të lejuara nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë.
- IV. Përgjegjës për zbatimin e kësaj Urdhërese janë Drejtorët e Drejtorive dhe Udhëheqësi i Zyrës së Personelit.
- V. Për mosrespektimin e kësaj Urdhërese do të ndërmerren masat përkatëse ligjore.
- VI. Urdhëresa i'u dorëzohet të gjithë punësuarve në Administratën e Komunës.

Nr. 02-202/04-0060758/20
Podujevë, 07 tetor 2020

Nënkyetari i Komunës
Nexhmi Rudari





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 17 shkronja (g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenet 8 paragraf 2.2 dhe 9 paragraf 1,2,3 të Rregullores (QRK) nr. 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, nenin 4.3 të Udhëzimit Administrativë (MPL) nr.02/2020 për procedurën e emërimit të Nënkyetarëve në Komuna dhe nenin 19 paragraf.1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, sipas shkresës së MAPL-së Nr.02-129/2 të dt.06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, merr:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT LOKAL PËR VLERËSIMIN E DËMEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA

Neni 1

Për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në të mirat materiale dhe të mirat tjera si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në territorin e Komunës së Podujevës, themelohet komisioni në përbërje;

1. Avni Syla, kryesues
2. Ymer Hoti, sekretar
3. Ismet Kadriu, anëtar
4. Hamide Aliu, anëtare
5. Kujtim Zhitia, anëtar

Neni 2

Mandati i Komisionit është katër (4) vjeçar.

Neni 3

Komisioni detyrat dhe përgjegjësit i ushtron sipas Rregullores (QRK) nr.17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-020/04-0061009/20
Podujevë,
08 tetor 2020



Nënkyetari i Komunës
Nexhmi Rudari



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja a) dhe 58 shkronjat d) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 16, 19 paragrafi 1.1 dhe 61 paragrafët 1.4 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18, në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot. 01-300/02-0007424/20 të datës 31 janar 2020 për miratimin e strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Podujevës për periudhën 2020/2022,

Në pajtim me nenin 4 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.02/2020 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në Komuna dhe sipas Shkresës së MAPL nr.prot.02-129/2 të datës 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, merr këtë,

VENDIM

Neni 1

Formohet komisioni për vlerësimin e zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal – SZHEL të Komunës së Podujevës për periudhën 2020-2022, në këtë përbërje;

- **Ejup Babatainca**, udhëheqës i sektorit për planifikim, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryesues,
- **Avni Syla**, udhëheqës i sektorit për zhvillim, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, anëtar
- **Fitore Blakçori**, zyrtare për shërbime sociale, në Drejtorinë e shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, anëtare
- **Rizah Muçolli**, zyrtar për mbrojtje të mjedisit, në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, anëtar
- **Ardian Emini**, zyrtar i SMIA, në Drejtorinë e Arsimit, anëtar

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1, ka për detyrë të analizoj, vlerësoj dhe konstatoj shkallën e zbatimit të SZHEL – 2020-2022, si dhe përfshirjen e planifikimeve në kuadër të planeve buxhetore të Komunës, sipas secilës Drejtori veç e veç.

Neni 3

Komisioni bashkëpunon dhe koordinon punët me Drejtoritë në funksion të disponimit me dokumentacione dhe të dhënat përkatëse, të nevojshme për vlerësimin e zbatimit të SZHEL 2020 – 2022.

Neni 4

Komisioni, për punën e kryer informon në formë të shkruar Zyrën e Kryetarit - Nënkyetarin e Komunës në një afat sa më optimal.

Iu dërgohet:

Anëtarëve të komisionit

Drejtorëve të drejtorive – për njoftim arkives

Nr.02-462/01-0062635/20
Podujevë, 15 tetor 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 4.3, të Udhëzimit Administrativ (MPL), nr.02/2020, për procedurën e emërimit të Nënkretarëve në komuna, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore 2021-2022 nr.01-400/03-0075925/19, dt. 23.09.2019, në rekomandim të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas Ftesës Publike nr. 12-320/01-0047502/20, dt. 18.08.2020, në pajtim me shkresën e MAPL-së nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkrjetari i Komunës, merr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MOTOKULTIVATORËVE ME PAJISJE PËRCJELLËSE NË PERIMKULTURË DHE PEMISHTE FERMERËVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

1. Ndahen 100 (njëqind) motokultivator me pajisje përcjellëse për fermerët përfitues nga Komuna e Podujevës, në projektin “Motokultivator me pajisje përcjellëse në primëkulturë dhe pemishte”, në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Projekti sipas ftesës publike, realizohet përmes formës së participimit dhe atë; Komuna e Podujevës subvencionon 70% të vlerës së projektit, ndërsa fermerët përfitues marrin pjesë me 30% të vlerës së projektit.

Neni 2

Subvencioni bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e përfituesve sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Zbatimin e Vendimit e bën Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave të cilat koordinojnë rreth aktiviteteve me fermerët përfitues me qëllim të implementimit të projektit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-320/01-0062904/2020
Podujevë, 16 tetor 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenin 16 dhe 61 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, nenit 4 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.02/2020 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në Komuna, sipas Shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me nr.prot.02-129/2 të datës 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, nxjerr;

VENDIM PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONIT PËR VEPRIME DHE MASA KUNDËR VIRUSIT EPIDEMIK COVID19 (SHTABI EMERGJENT)

Neni 1

1. Plotësohet dhe ndryshohet përbërja e komisionit të veçantë ad-hoc për ndërmarrjen e veprimeve dhe masave preventive në funksion të parandalimit të përhapjes së virusit epidemik COVID-19, në territorin e Komunës së Podujevës, dhe atë;

1.1. Në kuadër të përbërjes së këtij Komisioni përfshihet edhe,

➤ **z.Agim Blakçori**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit në komunën e Podujevës,

1.2. Për shkak të angazhimeve në punë dhe detyra tjera, bëhet zëvendësimi, dhe atë:

➤ **z.Bejtush Jashari**, U.D. i drejtorit të QKMF-së Podujevë, caktohet në vend të z.Fahri Llugaliu, ish U.D. drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare - QKMF,

➤ **z.Vail Shala**, Kryqi i Kuq i Kosovës – Sekretar në Degën Podujevë, caktohet në vend të znj.Donjeta Sheqiri, kryetare e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal – Podujevë.

Neni 2

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit nr.prot. Nr.02-020/04-0019708/20 të datës 13 mars 2020, dhe i njëjti hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I'u dërgohet,

*Palëve të cekura në këtë Vendim.
arkives*

Nr.02-020/04-0063043/20
Podujevë,
19 tetor 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, neni 4.3 të Udhëzimit Administrative (MPL) nr. 02/2020 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetareve në Komuna, nenin 10 parag.1 shkronja f) të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, në pajtim me shkresën e MAPL-së nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR znj. RIFADIE BLLACA PER REALIZIMIN E PROJEKTIT “PoDuArt Colony”

Neni 1

znj.Rifadie Bllaca nga Komuna e Podujevës, për promovimin e vlerave artistike dhe bukurive natyrore të Komunës së Podujevës, në kuadër të projektit “PoDuArt Colony” mbështetet me mjete financiare, në shumë 400 €.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-Teatri publik i qytetit “Avdush Hasani” dhe përmes bankës barten në llogarinë e znj.Rifadie Bllaca.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/01-0065033/20
Podujevë, 27.10.2020

Nënkyetari i Komunës
Nexhmi Rudari

